



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kuvendi Komunës së Prizrenit

Nr.001/011 - 165225

Më: 19 dhjetor 2024



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 12 paragrafit 1, 2 shkronja d), nenit 17 dhe nenit 40 paragrafit 2 shkronja l) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore, si dhe politikave nacionale dhe Programin e Kosovës për Barazi Gjinore, nenit 27 paragrafit 1 të Statutit të Komunës Nr. 01/011-5643, të datës 15 tetor 2008, pas shqyrtimit të propozimit, Kuvendi i Komunës së Prizrenit në mbledhjen e mbajtur më 19 dhjetor 2024, miratoi këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE DHUNA NDAJ GRAVE DHE DHUNA NË BAZA GJINORE 2024-2026

Neni 1

Miratohet Plani Lokal i Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore 2024-2026 në Komunën e Prizrenit.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi, është Plani Lokal i Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore 2024-2026.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdesen: Kryetari i Komunës, drejtoritë dhe njësitë – sektorët tjerë të përfshira në këtë Plan.

Neni 4

Vendimi, hyn në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikqyrës, konform nenit 81, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Kryesuesja e Kuvendit
Antigona Bytyqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prizrens
Opština Prizren –Municipality of Prizren



**Plani Lokal i Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna
ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore**

2024-2026

Lajmërimi i rasteve të dhunës në familje



Kontaktet:

Policia e Kosovës – Prizren – 038-550-999, 0800 1 9999 dhe 192

Qendra për Punë Sociale – Prizren - Telefoni kujdestar – +383 (0) 38 200 44 758

Thirrjet emergjente - 112

Zyra për Ndihmë dhe Mbrojtje Viktimave - 0800 11112, +383 44 310 468

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas – 0800 11 777

Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve – +383 29 234 794

Falënderim

Hartimi i Planit Lokal të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje Dhuna, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore (në tekstin e mëtejshëm i referohet si plani i veprimit) është përpjekje e përbashkët e Mekanizmit koordinues lokal kundër dhunës në familje (MKLDHF) në Prizren, nën koordinimin e Koordinatorës (drejtoresha e qendrës për punë sociale) të këtij Mekanizmi me përkrahjen e misionit të OSBE në Kosovë dhe një spektri të gjerë të partnerëve

Plani i veprimit është një prej dokumenteve më të rëndësishme të Komunës së Prizrenit, hartimi i së cilës ka ndjekur një proces të gjatë diskutimesh dhe kontributesh konkrete të shumë institucioneve relevante që punojnë në këtë fushë. Përfshirja dhe kontributi i tyre kanë dhënë frytin e punës që gjendet në faqet e këtij dokumenti për parandalimin e dhunës në familje në komunën tonë.

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE

- I. HYRJE PËRMBLEDHËSE**
- II. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PLANIT TË VEPRIMIT**
- III. PLANI I VEPRIMIT**
- IV. PLANI I MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT**

LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE

ANJF	Agjensioni për Ndihmë Juridike Falas
APRK	Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës
DHG	Dhuna ndaj grave
DHBGJ	Dhuna në baza gjinore
DHF	Dhuna në familje
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Shkencës
DKRS	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
DPMS	Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
DSH	Drejtoria e Shëndetësisë
PK	Policia e Kosovës
PSV	Procedurat Standarde të Veprimit
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QPS	Qendra për Punë Sociale
QSHM	Qendra e Shëndetit Mendor
TOR	Termet e Referencës
ZMNV	Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave
ZNJF	Zyra për Ndihmë Juridike Falas
ZBGJ/ZDNJ	Zyrtare/Zyrtar për Barazinë Gjinore / Drejtat e Njeriut

I. HYRJJE PËRMBLEDHËSE

Dhuna në familje është vepër penale¹ dhe fenomen që lëkund vlerat e shoqërisë demokratike. Kushtetuta e Republikës së Kosovës² në kuadër të parimeve të saj, mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, duke i konsideruar ato si të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme.

Me qëllim të parandalimit dhe ngritjes së efikasitetit të trajtimit të rasteve të dhunës në familje, duke synuar plotësimin e standardeve për ofrimin e mbrojtjes së duhur viktimave të dhunës në familje, në pajtim me Konventën e Stambollit, është hartuar Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore, që “dhunën në familje”³ e përkufizon: “nënkupton të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike dhe ekonomike që ndodhin brenda marrëdhënies në familje, ose njësisë shtëpiake, pavarësisht nga lidhja e gjakut apo marrëdhënies familjare, ose nga ish- partneri intim ose partneri intim aktual, pavarësisht nga fakti nëse ushtruesi i dhunës ndan apo ka ndarë të njëjtin banim me viktimën me qëllim të cenimit të dinjitetit dhe mbajtjes nën kontroll të vazhdueshëm dhe pozitë varësie, personat ndaj të cilëve është ushtruar dhuna”.

Duke u bazuar në obligimet që rrjedhin nga korniza ligjore dhe standardet ndërkombëtare, mbështetur në masë të gjerë në Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore si dhe politikat nacionale dhe Programin e Kosovës për Barazi Gjinore (2022 – 2026), që një herrit paraqet një vazhdimësi logjike të përkushtimit të institucioneve qeveritare për një zgjidhje funksionale dhe efektive për parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje dhe eliminimin e pabarazive e shtrirë në nivel lokal.

Duke dënuar të gjitha format⁴ e dhunës në familje dhe bazuar në jetësimin e parimit të Kartës së Kombeve të Bashkuara “*Të drejta të barabarta për burrat dhe gratë*”⁵, plani i veprimit është e përqendruar në fuqizimin dhe funksionalizimin e Mekanizmit Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, në përputhje me përgjegjësitë e tyre të përcaktuara në kuadër të Marrëveshjes së Mirëkuptimit⁶ (i datës 1 mars 2024), karshi institucioneve që përfaqësojnë në këtë trup institucional dhe përgjegjësi që rrjedhin nga marrëveshja e mirëkuptimit . kornizës ligjore në fuqi dhe obligimeve që rrjedhin nga Konventa e Stambollit për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, duke synuar rritjen e koordinimit efektiv dhe bashkërendimin e veprimeve në minimizimin e fenomenit të dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore (DHF, DHG dhe DHBGJ) dhe mbrojtjen e viktimës së dhunës.

¹ Kodi nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, neni 248;

² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli II;

³ Ligji nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore, neni 3: E definon si të tillë mes personave që janë/kanë qenë: të fejuar, të martuar; në bashkësi jashtëmartesore; bashkëjetojnë në ekonomi të përbashkët, janë prindër të përbashkët të një apo më shumë fëmijëve si dhe përdorin një shtëpi të përbashkët dhe janë në lidhje gjaku, krushqie, adoptimi, apo janë në lidhje kujdestarie, duke përfshirë prindërit, gjyshërit, fëmijët, nipat dhe mbesat nga vajza dhe djali, vëllezërit dhe motrat, hallat dhe tezet, dajat dhe xhaxhallarët, mbesat dhe nipërit nga vëllai dhe motra, kushërinjtë. Vegëza: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=83131>

⁴ Dhuna në familje, dhuna fizike, psikologjike, seksuale dhe ekonomike, për nevojat e kësaj strategjie do të jetë e njëjtë siç është përkufizuar në dispozitën e nenit 3, nën paragrafi 1.2. të Ligjit nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore;

⁵ OKB, Karta e Kombeve të Bashkuara, neni 1, 1945;

⁶ Marrëveshje Mirëkuptimi për Institucionalizimin e Mekanizmit Koordinues Kundër Dhunës në Familje dhe Mënyrën e Funksionimit të të tij, në Komunën e Prizrenit më datë 1 mars 2024;

Njëherit, kërkon sigurimin e zbatimit të kornizës ligjore, politikave nacionale dhe standardeve ndërkombëtare për parandalimin, identifikimin pro-aktiv dhe luftimin e dhunës në familje, si dhe reagimit të menjëhershëm dhe të vazhdueshëm në ofrimin e shërbimeve cilësore për mbrojtje dhe trajtim të rasteve të dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore. Po ashtu, synon që duke marrë masa efektive në rritjen e koordinimit dhe bashkërendimit të veprimeve në mes të akterëve relevantë, të nxitet përparimi shoqërorë ku shoqëria është e vetëdijshme dhe mbështetëse e të drejtave të njeriut për të qenë të lirë nga të gjitha format e dhunës që promovon fuqizimin social dhe ekonomik të vajzave dhe grave dhe DHF, DHG dhe DHBGJ të bëhet e papranueshme në komunitetin tonë.

II. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PLANIT TË VEPRIMIT

Ndonëse, dhuna në familje dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore është shkelje e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut⁷ dhe përbën goditje të dinjitetit njerëzor, si në gjithë globin edhe në shoqërinë kosovare ajo vazhdon të jetë e përhapur me përmasa mjaftë të mëdha.

Dhuna ndaj grave është manifestim i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të pushtetit midis burrave dhe grave⁸ dhe me të drejtë konsiderohet pengesa më e madhe në realizimin e një bote paqësore, të prosperuar dhe të qëndrueshme. Krahas vështirësive ekonomike, shoqëria jonë po ballafaqohet edhe me një sërë problemesh tjera si: papunësia, lëvizjet demografike, ndryshime të koncepteve mbi vlerat dhe virtytet njerëzore, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në pjesëmarrjen e ulët të gruas në vendimmarrje dhe pabarazisë gjinore.

Duke qene se DHF, DHG dhe DHBGJ gjithnjë e më shumë po njihet jo vetëm si shkelje e të drejtave individuale, por edhe si kërcënim për demokracinë, pengesë për zhvillim shoqëror dhe rrezik për paqe të qëndrueshme, pasojat e së cilës tronditin jo vetëm rrethim e ngushtë të familjes por të gjithë shoqërinë, dhe si e tillë kërkon angazhim të gjithë shoqërisë për marrjen e masave të nevojshme për parandalimin dhe luftimin e DHF, DHG dhe DHBGJ.

Para së gjithash plani do të ndikoj në rritjen e bashkëpunimit në mes të qytetarit dhe institucioneve shtetërore, shtyllat e së cilës janë të vendosura në “parandalimin e dhunës, mbrojtjen e viktimave të saj dhe ndjekja penale e dhunuesve”. Ajo synon gjithashtu të ndryshojë mendësitë e individëve duke iu bërë thirrje pjesëtarëve të shoqërisë, në veçanti burrave dhe djemve, të ndryshojnë sjellje.

Plani lokal i veprimit kundër Dhunës në Familje për Komunën e Prizrenit, synon të:

- Të punojë në parandalimin e DHF, DHG dhe DHBGJ dhe ngritjen e vetëdijes tek komuniteti për aspektet negative të këtij fenomeni;
- Të përmirësojë/ndërtojë sistemin e grumbullimit dhe shkëmbimit të të dhënave në mes të akterëve relevant;
- Të fuqizojë mekanizmat për reagim sa më të shpejtë ndaj rasteve të DHF, DHG dhe DHBGJ dhe të përmirësojë koordinimin në mes anëtarëve të grupit gjatë menaxhimit të tyre;

⁷ Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, 1994; <https://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/ViolenceAgainstWomen.aspx>, qasur më 1 korrik 2021;

⁸ Këshilli i Europës, Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, preambula, 2011;

- Të bëjë avokim dhe monitorim të zbatimit të politikave si dhe të sugjerojë ndryshime bazuar në përvojat më të mira nga terreni.

Mbështetur në tri fusha të veprimit, si “*Vetëdijësimi dhe Parandalimi*”; “*Mbrojtja dhe Koordinimi*”; “*Fuqizimi ekonomik, rehabilitimi dhe riintegrimi*” me anë të adresimit të objektivave strategjike dhe specifike, si:

- 1. Objektiva Strategjike #1:** Përmirësimi i sistemit institucional për parandalim dhe ofrim të shërbimeve cilësore për mbrojtje nga DHF, DHG dhe DHBGJ:

Objektiva specifike #1.1: Ngritja e kapaciteteve të profesionistëve për parandalimin dhe luftimin e DHF, DHG dhe DHBGJ;

Objektiva specifike #1.2: Vetëdijësimi i opinionit publik për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe DHF, DHG dhe DHBGJ;

- 2. Objektiva Strategjike # 2:** Përmirësimi i qeverisjes lokale për parandalimin dhe mbrojtje nga DHF, DHG dhe DHBGJ;

Objektiva specifike # 2.1: Funkcionalizimi i Mekanizmit Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje;

Objektiva specifike # 2.2: Fuqizimi i sistemit të raportimit dhe ankesave për mbrojtje nga DHF, DHG dhe DHBGJ;

Objektiva specifike # 2.3: Avancimi i monitorimi të politikave dhe obligimeve ligjore për mbrojtje nga DHF, DHG dhe DHBGJ

Objektiva specifike # 2.4: Fuqizimi ekonomik i grave dhe viktimave të DHF, DHG dhe DHBGJ

;

- 3. Objektiva Strategjike # 3:** Fuqizimi i shërbimeve rehabilituese dhe riintegruese të viktimave të DHF, DHG dhe DHBGJ;

Objektiva specifike # 3.1: Avancimi i shërbimeve rehabilituese për mbrojtje nga DHF, DHG dhe DHBGJ;

Objektiva specifike #3.2: Avancimi i shërbimeve riintegruese për mbrojtje nga DHF, DHG dhe DHBGJ;

III. PLANI I VEPRIMIT 2024-2026

Nr.	Objektivat strategjike dhe veprimet	Vlera bazë	Objektivi përkohshëm [2024]	Synimi i vitit të fundit [2026]	Rezultati				
I.	Objektivi strategjik: Përmirësimi i sistemit institucional për parandalim dhe ofrim të shërbimeve cilësore për mbrojtje nga DHF, DHG dhe DHBGJ								
1	Treguesi: % e mekanizmave institucional kanë njohurit e duhura për parandalim dhe ofrim të shërbimeve cilësore për mbrojtje nga DHF, DHG dhe DHBGJ	30 %	50 %	70 %	Promovimi i barazisë thelbësore midis burrave dhe grave dhe marrja e masave të nevojshme për parandalimin dhe luftimin e DHF, DHG dhe DHBGJ				
2	Treguesi: % e popullsisë kanë njohurit e duhura për parandalim dhe reagim ndaj DHF, DHG dhe DHBGJ	25%	35%	50%	Qytetarët e Komunës së Prizrenit kanë njohurit e duhura për rolin dhe përgjegjësin qytetare për mbrojtje dhe respektim të të drejtave të njeriut dhe parandalim të DHF, DHG dhe DHBGJ				
I.1	Objektivi specifik: Ngritja e kapaciteteve të profesionistëve për parandalimin dhe luftimin e DHF, DHG dhe DHBGJ								
1	Treguesi: Nr. i profesionistëve kanë njohurit e duhura për standardet ndërkombëtare për parandalim dhe luftim të DHF, DHG dhe DHBGJ	30 %	50 %	70%	Parimet dhe standardet ndërkombëtare për parandalim dhe luftim të dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore janë pjesë integrale në përditshmërinë e mekanizmave relevant				
2	Treguesi: Nr. i profesionistëve kanë njohurit e duhura për obligimet që rrjedhin nga korniza ligjore vendore për parandalim dhe luftim të DHF, DHG dhe DHBGJ	30%	50%	70%	Prioritizimi dhe rritja e efikasitetit të trajtimit të rasteve për parandalim dhe luftim të DHF, DHG dhe DHBGJ				
Nr.	Veprimi	Afati i fundit	Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca dokumente në
			2024	2025	2026				

I.1.1	Realizimi i sesioneve informuese për Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë; trajnime të anëtarëve të MK për kornizën ligjore dhe menaxhimin e rasteve; ngritja e kapaciteteve të profesionistëve institucional për Konventën e Këshillit të Europës; Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga DHF, DHG dhe DHBGJ; bashkërendimin e rasteve për parandalimin dhe mbrojtje nga dhuna në familje	2024 -2026		1500 €	2000 €	2000 €	Komuna Donatorët	Komuna ZBGJ, PK, QPS, ZMNV dhe ZNJF	2 takime me përfaqësuesit institucional te nivelit lokal kanë njohurit e duhura për Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë; -1 takimme profesionistët institucional kanë njohurit e duhura për Konventën e Këshillit; - 1 takim; Profesionistët institucional kanë njohurit e duhura për Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga DHF, DHG dhe DHBGJ; -6 sesione informuese brenda vitit për bashkërendimit të rasteve	Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë; Konventën e Këshillit të Europës; Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga DHF, DHG dhe DHBGJ ;
I.1.2	Punësimi i psikologut/pedagogut/punëtori social në çdo shkollë	2024-2026	Target i arrihet 2024 / 26			Komuna DKA DPMS Donator	Komuna DKA DPMS	Aktualisht janë punësuar 18 psikolog në shkollat e Prizrenit	Ligji për Arsimin Parauniversitar; Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021;	

				psikolog/e					Në vitin 2025/2026 do shtohen edhe 25 psikolog/e? (te konfirmohet me DKA nese 18 psikolog i plotesojn nevojat e shkollave dhe nese ka planet per shtimin e ketij numri); Të kërkohet donatori ose me buxhet të DPMS për punësimin e punëtorëve social nëpër shkolla si pilot projekt; -Shkolla ka kuadrin profesional për parandalim, trajtim dhe raportim të rasteve të dhunës ndaj vajzave dhe dhunës ne familje	Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga DHF, DHG dhe DHBGJ;
I.1.3	Ngritja e njohurive te mësimdhënësve ne identifikimin dhe raportimin e rasteve të dhunës në DHF, DHG dhe DHBGJ;	2024-2026		1000 €	2000 €	2000 €	Komuna Donatorët	Komuna DKA (Ekipet për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe	150 mësimdhënës/e për periudhen 2024/2026 - Mekanizmat e shkollës kanë njohurit e duhura për parandalimin,	Ligji për Arsimin Parauniversitar; Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga DHF, DHG dhe DHBGJ;

							Mosregjistri mit në Arsimin e Obliguar; këshillat e prindërve)	identifikimin dhe raportimin e rasteve të dhunës ndaj vajzave dhe dhunës në familje; DKA/donator përkrahë shkollat në draftimin e rregullores së brendshme për parandalim dhe indetifim të DHF	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2022-2026;	
I.1.4	Vizitë studimore lidhur me funksionimin e mekanizmit koordinues ne trajtimin të rasteve të dhunës në familje	2024-2026			1000 Euro	1000 Euro	Komuna Donator ët	Komuna	Rritja e njohurive mbi trajtimin e rasteve të DHF, DHG dhe DHBGJ sipas standardeve ndërkombëtare;	Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;
	Buxheti i përgjithshëm për Objektivin Specifik I.1:									
	<i>Nga të cilat kapitale:</i>									
	<i>Nga të cilat rrjedhëse:</i>									
I.2		Objektivi specifik: Vetëdijesimi i opinionit publik për parandalimin dhe luftimin e DHF, DHG dhe DHBGJ								
1	Treguesi: % e qytetarëve kanë njohurit e duhura për përgjegjësitë qytetare për parandalim dhe reagim ndaj dhunës në DHF, DHG dhe DHBGJ;		20%	40%		60%			Familja është institucion ku të gjithë anëtarët janë të sigurt, jetojnë në një atmosferë lumturie, dashurie dhe mirëkuptimi që nxitë barazinë në mesin e anëtarëve të saj.	
2	Treguesi: % e qytetarëve që kanë përfituar nga aktivitetet								Rritja e vetëdijesimit të shoqërisë për t'i thënë ndal dhunës në DHF, DHG dhe DHBGJ	

Nr.	Veprimi	Afati i fundit	Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referencat në dokumente
			2024	2025	2026				
I.2.1	Organizimi i fushatës vetëdijësuese për të drejtat e njeriut me fokus të drejtat e grave në kuadër të Fushatës së “16 Ditëve të Aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore”; Fushatë vetëdijësuese lidhur me manifestimet e formave të DHF, DHG dhe DHBGJ, pasojat e saj dhe nevojën për të parandaluar dhunën; Shtypja dhe shpërndarja e “Konventës të Stambollit”	2024-2026	2000€	4000€	4000€	Komuna Donatorët /OJQ	Komuna ZBGJ	Rritja e njohurive të qytetarëve për të drejtat e njeriut dhe drejtat e grave; Rritja e ndërgjegjësimit dhe perceptimit nga publiku i gjerë lidhur me format e dhunës; Mekanizmat përgjegjës institucional njihin masat e vëna në dispozicion të “Konventës të Stambollit”	Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi; Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje; Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga DHF, DHG dhe DHBGJ;
I.2.2	Realizimi i sesioneve informuese me fëmijë dhe të rinj për rolin dhe përgjegjësit e institucioneve që ofrojnë shërbime për mbrojtjen e viktimave të dhunës	2026	1 sesion; Asambleja e fëmijëve	1 sesion; Asambleja e fëmijëve	1 sesio; Asambleja e fëmijëve	Komuna Donatorët	Komuna DKRS ZBGJ	Fëmijët dhe të rinjtë kanë njohuri të duhura për rolin dhe përgjegjësitë e institucioneve përkatëse (si: PK, QPS, ZMNV, ZNJF, strehimoret)	Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje
I.2.3	Realizimi i sesioneve informuese me gra dhe viktimat të dhunës në familje për rolin dhe përgjegjësitë e institucioneve që ofrojnë shërbime për mbrojtjen e viktimave të dhunës	2026	500 €	1000 €	1000 €	Komuna Donatorët	Komuna ZBGJ OJQ-të	10 sesione në strehimore me Gratë dhe viktimat e dhunës në familje, kanë njohuri të duhura për rolin dhe përgjegjësitë e	Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje

									institucioneve përkatëse (si: PK, QPS, ZMNV, ZNJF, strehimoret dhe OJQ-të të profilizuara në këtë lëmi)	
I.2.4	Organizimi i aktiviteteve jo-formale (përmes artit, eseve, ekspozitave, dramave, etj) me fokus parandalimin dhe mbrojtjen nga DHF, DHG dhe DHBGJ	2026		500 €	1000 €	1000 €	Komuna Donatorët	Komuna ZBGJ OJQ-të	DKA informate metutje! Rritja e vetëdijesimit të shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar pabarazitë dhe dhunën në familje;	Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje; Ligji për Arsimin Parauniversitar; Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2022-2026;
I.2.5	Informimi i publikut përmes rrjeteve sociale për mbrojtjen që iu ofrohet viktimave të DHF, DHG dhe DHBGJ dhe institucionet përkatëse ku duhet të orientohen	2026					Komuna Donatorët	Komuna ZBGJ, OJQ-të	KP- me perdore vetem nje platforme; Opinioni publik ka njohurin e duhur për ekzistencën dhe rolin e shërbimeve për mbrojtje nga DHF, DHG dhe DHBGJ	Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë
Buxheti i përgjithshëm për Objektivin Specifik I.2:										
<i>Nga të cilat kapitale:</i>										
<i>Nga të cilat rrjedhëse:</i>										
Nr.	Objektivat strategjike dhe veprimet		Vlera bazë	Objektivi përkohshëm [2024]	i i vitit të fundit [2026]	Rezultati				
II.	Objektivi strategjik: Përmirësimi i qeverisjes lokale për parandalimin dhe mbrojtje nga DHF, DHG dhe DHBGJ									

1	Treguesi: Komuna ka zhvilluar politika lokale për parandalimin dhe mbrojtje nga DHF, DHG dhe DHBGJ		1	5	7	Parandalimi dhe mbrojtja e viktimave të dhunës në familje janë vendosur në agjendën e prioriteteve të qeverisjes lokale			
II.1		Objektivi specifik: Funkcionalizimi i Mekanizmit Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje							
1	Treguesi: Nr. i takimeve të realizuara nga Mekanizmi Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje		6	6	6	Mekanizmi Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, i fuqizuar sipas TOR			
2	Treguesi: Nr. i aktiviteteve të realizuara nga Mekanizmi Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje		5	4	12	Rritja e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstytucional			
Nr.	Veprimi	Afati i fundit	Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca në dokumente
			2024	2025	2026				
II.1.1	Hartimi i Rregullores së Punës të Mekanizmit Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje	2026				Komuna Bashkepunetore e jashtem	Komuna Koordinatore DNJ-BGJ	Rregullorja e Punës e Mekanizmit Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, e aprovuar	Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga DHF, DHG dhe DHBGJ; Marrëveshja e Mirëkuptimit për institucionalizimin e Mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje;
II.1.2	Hartimi dhe publikimi i raportit të monitorimit për mbrojtje nga DHF, DHG dhe DHBGJ; Hartimi dhe adresimi i rekomandimeve	2024-2026				Komuna Bashkepunetore	Komuna Komuna	Raporti i monitorimit për mbrojtje nga dhuna në familje i hartuar nga Mekanizmi Koordinues	Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga DHF, DHG dhe DHBGJ;

	për qeverisjen lokale lidhur me marrjen e masave për parandalim, trajtimin, strehimin dhe mbrojtje të DHF, DHG dhe DHBGJ ; Hartimi dhe adresimi i rekomandimeve për qeverisjen lokale						ore e jashtëm	Koordinator DNJ-BGJ	Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje; Rritja e koordinimit institucional	Marrëveshja e Mirëkuptimit për institucionalizimin e Mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje;
	Buxheti i përgjithshëm për Objektivin Specifik II.1:									
	<i>Nga të cilat kapitale:</i>									
	<i>Nga të cilat rrjedhëse:</i>									
II.2		Objektivi specifik: Fuqizimi i sistemit të raportimit dhe ankesave për mbrojtje nga DHF, DHG dhe DHBGJ								
1	Treguesi: Nr. i rasteve të raportimit të DHF, DHG dhe DHBGJ		X	X		X			Qytetarët janë inkurajuar të raportojnë rastet e DHF, DHG dhe DHBGJ në institucionet përkatëse	
2	Treguesi: Nr. i ankesave të parashtruara nga viktimat e DHF, DHG dhe DHBGJ		X	X		X			Viktimat e dhunës në familje përdorin shërbimet e specializuara	
Nr.	Veprimi	Afati i fundit		Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca në dokumente
				2024	2025	2026				
II.2.1	Identifikimi i rasteve të dhunës në familje nëpërmjet mbledhjes periodike të të dhënave në terren	2026		500	500	500	Komuna	Komuna	Rritja e numrit të rasteve të identifikuar në terren nga mekanizmat relevantë;	Ligji për familjen; Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga DHF, DHG dhe DHBGJ; Ligji për Policinë;

II.2.2	Vizualizimi i shërbimeve që ofrohen nga Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave dhe Zyra për Ndihmë Juridike Falas dhe Qendra për Punë Sociale	2026					Komuna Donat orët OJQ-të	ZMNV, ZNJF, QPS	Rritja e vizibilitetit të mandatit dhe shërbimeve që ofrohen nga Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave dhe Zyra për Ndihmë Juridike Falas	Ligji për Ndihmë Juridike falas Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare Udhëzim për PSV për ZMNV Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga DHF, DHG dhe DHBGJ;
II.3	Objektivi specifik: Avancimi i monitorimi të politikave dhe obligimeve ligjore për mbrojtje nga DHF, DHG dhe DHBGJ									
1	Treguesi: treguesit për mbrojtjen nga DHF, DHG dhe DHBGJ		Treguesit e identifikuar	Treguesit e përfshirë në bazë të të dhënave	Baza e të dhënave funksionale				Integrimi i sistemit lokal për mbrojtje nga DHF, DHG dhe DHBGJ	
2	Treguesi: raporti i monitorimit i publikuar				Raport i vjetor				Vlerësimi i progresit të zbatimit të politikave dhe obligimeve ligjore për mbrojtje nga DHF, DHG dhe DHBGJ	
Nr.	Veprimi	Afati i fundit		Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca në dokumente
				2024	2025	2026				
II.3.1	Grumbullimi i të dhënave të standardizuara mbi DHF, DHG dhe DHBGJ; Përcaktimi i nevojave, sfidave, përparësive dhe marrja e masave në bazë të analizës së të dhënave për parandalimin dhe mbrojtjen nga						Komuna Donat orët	Komuna	Komuna në vazhdimësi gjeneron të dhëna për mbrojtje nga DHF, DHG dhe DHBGJ; Orienton politikën dhe veprimet institucionale bazuar në të dhëna	Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje; Ligji për parandalimin dhe

	DHF, DHG dhe DHBGJ; Hartimi i raportit vjetor për mbrojtje nga DHF, DHG dhe DHBGJ; Ngritja e kapaciteteve të institucioneve për të siguruar mbledhjen, përdorimin dhe analizën e të dhënave cilësore	2024-2026							cilësore; Raporti vjetor mbi situatën për parandalimin dhe mbrojtjen nga DHF, DHG dhe DHBGJ, i publikuar; Zyrtarët institucional kanë njohurit e duhura për mbledhjen, përdorimin dhe analizimin e të dhënave;	mbrojtjen nga DHF, DHG dhe DHBGJ; Marrëveshja e Mirëkuptimit për institucionalizimin e mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje;
II.4	Objektivi specifik: Fuqizimi ekonomik i grave dhe viktimave të DHF, DHG dhe DHBGJ									
1	Treguesi: Nr. i viktimave të dhunës në familje të punësuara		X	X		x	Janë fuqizuar ekonomikisht viktimat e DHF, DHG dhe DHBGJ			
2	Treguesi: Nr. i politikave komunale për mbrojtjen e viktimave të DHF, DHG dhe DHBGJ të aprovuara		X	X		X	Komuna ka marrë të gjitha masat administrative afirmative për mbrojtjen e viktimave të DHF, DHG dhe DHBGJ			
Nr.	Veprimi	Afati i fundit	Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca në dokumente	
			2024	2025	2026					
II.4.1	Referimi i rasteve për ngritje profesionale ne qendrat e aftësimiit profesional për viktimat e DHF, DHG dhe DHBGJ	2026				Komuna APRK Donatorët	Komuna	Viktimat e dhunës në familje, profilizohen me profesione të caktuara	Strategjia Kombëtare për Zhvillim; Programi i Kosovës për barazi Gjinore 2020-2024; Objektiva 5 për Zhvillim të Qëndrueshëm	

II.4. 2	Subvencionimi/përkrahja e projekteve për rehabilitim dhe riintergrim të viktimave të DHF, DHG dhe DHBGJ ; Ndërmjetësimi për punësim për viktimat e DHF, DHG dhe DHBGJ	2024 - 2026					Komuna; Zyra e punësimi	10 projektet zhvillimore/ biznesore të viktimave të DHF, DHG dhe DHBGJ janë subvencionuar nga Komuna; Rritja e numrit të viktimave të DHF, DHG dhe DHBGJ që janë punësuar	Strategjia Kombëtare për Zhvillim; Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga DHF, DHG dhe DHBGJ ; Objektiva 5 për Zhvillim të Qëndrueshëm
Nr.	Objektivat strategjike dhe veprimet		Vlera bazë	Objektivi përkohshëm [2024]	Synimi i vitit të fundit [2026]	Rezultati			
III.	Objektivi strategjik: Fuqizimi i shërbimeve rehabilituese dhe riintegruese të viktimave të DHF, DHG dhe DHBGJ								
1	Treguesi: Nr. i shërbimeve rehabilituese për viktimat e DHF, DHG dhe DHBGJ		180	200	200	Lehtësimi i qasjes dhe rritja e kualitetit të shërbimeve rehabilituese për viktimat e DHF, DHG dhe DHBGJ;			
2	Treguesi: Nr. i shërbimeve riintegruese për viktimat e DHF, DHG dhe DHBGJ		X	X	X	Lehtësimi i qasjes dhe rritja e kualitetit të shërbimeve riintegruese për viktimat e DHF, DHG dhe DHBGJ;			
III.1	Objektivi specifik: Avancimi i shërbimeve rehabilituese për mbrojtje nga DHF, DHG dhe DHBGJ								
1	Treguesi: Nr. i shërbimeve rehabilituese të qasshme		X	X	X	Është lehtësuar qasja në shërbime rehabilituese, efikase dhe të qëndrueshme, për viktimat e DHF, DHG dhe DHBGJ ;			
2	Treguesi: % e buxhetit në dispozicion për ofrimin e shërbimeve rehabilituese për mbrojtje të viktimave të DHF, DHG dhe DHBGJ		X	X	X	Komuna alokon buxhet të nevojshëm për ofrimin e shërbimeve rehabilituese për mbrojtje të viktimave të DHF, DHG dhe DHBGJ;			
Nr.	Veprimi	Afati i fundit	Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe	Produkti (Output)	Referenca në dokumente
			2024	2025	2026				

							mbështetës			
III.1.1	Ofrimi i strehimit social për viktimat e DHF, DHG dhe DHBGJ	2026		40,000,00	40.000,00	/	Komuna Donatorët	Komuna	Viktimave të DHF, DHG dhe DHBGJiu ofrohet strehim; Komuna ka përpiluar plan për banim social dhe janë ndarë mjete buxhetore ku përfshihen edhe rastet e DHF.	Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore; Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga DHF, DHG dhe DHBGJ;
III.1.2	Ndarja e buxhetit për ofrimin e shërbimeve emergjente për viktimat e DHF, DHG dhe DHBGJ	2026		1000 €	2000 €	2000€	Komuna Donatorët	Komuna	Shërbimet emergjente të bugjetuara dhe në dispozicion 24/7 për viktimat e DHF, DHG dhe DHBGJ ;	Konventa për parandalimin dhe luftimin e DHF, DHG dhe DHBGJ;
III.1.3	Mbështetja e strehimores për raste e DHF, DHG dhe DHBGJ	2026		8000€	8000€	8000€	Komuna Donatorët	Komuna	Viktimave të dhunës në familje iu ofrohen shërbime rehabilituese profesionale (Shuma prej 8000 € në vit që alokohet për mbështetjen e strehimores)	Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje; Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Baza Gjinore;
III.1.4	Ofrimi i shërbimeve psiko-sociale për viktimat dhe kryerësit e DHF, DHG dhe DHBGJ	2026		1000€	2000€	2000€	Komuna Donatorët	Komuna, QPS, QSHM, OJQ	QPS: Viktimave dhe kryerësit e dhunës në familje iu ofrohen	Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe

							QSH M, ANJF,		shërbime profesionale psiko-sociale	dhunës në familje; Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga DHF, DHG dhe DHBGJ;	
III.1. 5	Ofrimi i shërbimeve mjekësore dhe këshilluese për ruajtjen e shëndetit mendor për viktimat e DHF, DHG dhe DHBGJ	2026		500		500	700	Komu na Donat orët QSH M QKM F	Komuna DSH	Viktimave të dhunës në familje iu ofrohen shërbime profesionale për ruajtjen e shëndetit mendor	Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje; Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga DHF, DHG dhe DHBGJ ;
	Buxheti i përgjithshëm për Objektivin Specifik III.1:										
	<i>Nga të cilat kapitale:</i>										
	<i>Nga të cilat rrjedhëse:</i>										
III.2		Objektivi specifik: Avancimi i shërbimeve riintegruese për mbrojtje nga DHF, DHG dhe DHBGJ									
1	Treguesi: Nr. i viktimave të DHF, DHG dhe DHBGJ		X	X	X	X	X			Fuqizimi i viktimave të DHF, DHG dhe DHBGJ për jetesë të pavarur	
2	Treguesi: Nr. i viktimave të DHF, DHG dhe DHBGJ përfitues të subvencioneve nga komuna		X	X	X	X	X			Fuqizimi i viktimave të DHF, DHG dhe DHBGJ për jetesë të pavarur	
Nr.	Veprimi	Afati i fundit	Buxheti			Burim i i financ imit	Institucio ni udhëheqë s dhe mbështet ës	Produkti (Output)	Referenca dokumente	në	
			2024	2025	2026						

IV. PLANI I MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT

Synimi kryesorë i Komunës Prizrenit pa dyshim se është realizimi i aktiviteteve dhe objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit nëpër vite.

Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit, do të shtrihet në të gjitha institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për realizimin e objektivave të përcaktuara në Plan të Veprimit.

Për ta vlerësuar cilësinë dhe efektivitetin e ndërhyrjeve, apo anasjelltas, Mekanizmi Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje do të raportoj përparimin në zbatimin e planit në baza vjetore.

Koordinatorë e Mekanizmi Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Koordinatorë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore do të ketë rolin udhëheqës për të bashkërenduar punën, mbikëqyrur dhe vlerësuar procesin e zbatimit të Planit të Veprimit, në të njëjtën kohë do të shërbejë si Sekretariat, dhe në baza periodike çdo vit/6 muaj do të raportojë direkt Kryetarit të Komunës.

Me ç' rast, çdo fund vit Mekanizmi Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje është i obliguar të hartojnë "Raportin e Monitorimit" mbi zbatimin, i cili do të jetë treguesi kyç për të pasqyruar qartë progresin apo regresin mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe aktiviteteve të parapara në Planin e Veprimit.

Shëhim zyrtar: ky plan është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Prizrenit të mbajtur më 19 dhjetor 2024.



**Kryesuesja e Kuvendit
Antigona Bytyqi**